



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2527/2 prot

Datë 18.10.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME.

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GEGA CENTER GKG” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*,” me nr REF-80592-09-20-2023 me objekt “*Blerje karburanti*” me fond limit 16.800.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “UFO CENGU” SHPK, me NIPT: L18328201N
Adresa: Lagjja Ramhas, Rruga Deshmoreve, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 8/8, Kukës
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kukës
Adresa: Sheshi „Skenderbej“, lagjia Nr.5, Kukes
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “GEGA CENTER GKG” SHPK, me NIPT: K66801001T
Adresa: *Njesia Nr.1, Rruga Ali Demi, godina nr 110,pasuria me Nr.8/745, Zone Kadastrale 8150, Tiranë*

Në datën 17.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3503 dhe me nr. 2527 protokollit datë 17.10.2023 e operatorit ekonomik “UFO CENGU” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur*,” me nr REF-80592-09-20-2023 me objekt “*Blerje karburanti*” me fond limit 16.800.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GEGA CENTER GKG” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

-Komisioni i prokurimit Publik Publikon kriteret mbi te cilat ankimuesi pretendon se operatori ekonomik “GEGA CENTER GKG” SHPK nuk i plotëson:

a. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

c.Operatori ekonomik pjesmarres duhet te dorezoje aktin e Autorizimit per tregtimin e karburanteve dhe lendeve djegese te leshuar/nenshkruar nga titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia-Kukes.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

c. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku ushtron aktivitet subjekti ekonomik **për vitin 2022** (Sipas QKB) “**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 18.10.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova